



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.5/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët; Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik “Lista Serbe”, me seli në Mitrovica e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. vendimi nr. 01/824-2026 i datës 16.05.2026, për certifikimin e dhjetë (10) kandidatëve të subjektit politik “Za Slobodu Pravdu i Opstanak” për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.05.2026, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik “Lista Serbe”, me seli në Mitrovica e Veriut, ZP.Anr.5/2026, e datës 17.05.2026, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 01/824-2026, të datës 16.05.2026, për certifikimin e dhjetë (10) kandidatëve të subjektit politik “Za Slobodu Pravdu i Opstanak” për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.5/2026, të datës 16.05.2026, nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovica e Veriut, në të cilën theksohet se më 16 maj 2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajti një mbledhje ku miratoi vendimin 01/824-2026 dhe certifikoi kandidatët e subjekteve politike për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që

do të mbahen më 7 qershor 2026. Sipas parashtruesit të ankesës ndër kandidatët e certifikuar janë edhe kandidatët e subjektit politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", përfshirë kandidatë që nuk janë anëtarë të komunitetit serb: Alil Đerlek, i cili është shtetas i kombësisë Boshnjake, dhe Lazar Radulović, i cili deklarohet publikisht si Malazez. Parashtruesi i ankesës thekson se duke pasur parasysh se subjekti politik i përmendur u regjistrua për pjesëmarrje në zgjedhje me kandidatë që kandidonin për vendet e garantuara për komunitetin serb në përputhje me nenin 64 të Kushtetutës së Kosovës, ne konsiderojmë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shkelur kushtetutën dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme duke certifikuar personat për kandidim për vendet që i përkasin popullit serb.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë përbërje etnike të kandidatëve, subjekti politik i përmendur ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje, por jo të marrë pjesë në procesin zgjedhor me qëllim të fitimit të vendeve në parlament që i përkasin popullit serb. Në ankesën e tij parashtruesi i ankesës thekson se në të njëjtat situata kur ishin në pyetje kandidatë të kombësisë shqiptare në listat e partive boshnjake, KQZ-ja kishte marrë vendim që ata kandidatë të mos certifikoheshin. Andaj propozojnë që PZAP-i ta pranojë ankesën si të bazuar, të vërtetohet se vendimi nr. 01/824-2026 i datës 16.5.2026 për Certifikimin e kandidatëve të subjektit politik " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak " është I PALIGJSHËM dhe se është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nr. 08/L-228, dhe të urdhërojë KQZ-në moscertifikimin e kandidatëve të cilët nuk janë të nacionalitetit serb. Si dëshmi ka bashkangjitur vendimin nr. 01/824-2026 i datës 16.5.2026 për Certifikimin e kandidatëve të subjektit politik " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak".

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se periudha e aplikimit për certifikimin e subjekteve politike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat mbahen më 07.06.2026, ka filluar më 2 maj 2026 dhe ka përfunduar më 10 maj 2026 në orën 24:00. Duke pasur parasysh që procesi zgjedhor i jashtëzakonshëm realizohet me afate të shkurtuara, afati për certifikim sipas Planit Operacional ka qenë i hapur për nëntë (9) ditë. Duke qenë se afati ka përfunduar më 10 Maj në ora 24:00, Zyra ka filluar verifikimin e aplikimeve për certifikimin menjëherë më datën 11 maj 2026. Subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak ka aplikuar për certifikimin e dhjetë (10) kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 7 Qershor 2026. Ky subjekt politik ka përcjellë të gjithë hapat e nevojshëm duke ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara në platformën elektronike për certifikim. Lista me kandidatë është verifikuar sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 30 (Përshtatshmëria/aftësia e kandidatit) të Ligjit NI. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në

Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e verifikuara të pranuar nga institucionet, rezulton se asnjë kandidat nuk bie ndesh me dispozitat e përcaktuara në nenin 30 Ligjit Nr. 08/1228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Zyra nuk ka pranuar asnjë ankesë në lidhje me kandidatët e subjektit politik Za Slobodzu Pravdu i Opstanak në lidhje me përkatësinë etnike të tyre. Me rastin e futjes së kandidatëve në platformën elektronike nga vetë subjekti politik, platforma bën validimin e secilit kandidat duke krahasuar të dhënat personale të kandidatëve me ekstraktin e listës votuese për të vërtetuar që secili prej tyre është votues i regjistruar në Republikën e Kosovës. Regjistri Civil në Republikën e Kosovës nuk ka të dhëna në lidhje me përkatësinë etnike, andaj Zyra e ka të pamundshme të bëjë verifikim të përkatësisë etnike të kandidatëve. Andaj, Zyra i ka rekomanduar KQZ, të certifikoj listën e kandidatëve me 10 kandidatë të subjektit politik ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK. Rekomandimi i Zyrës është prezantuar në takim me KQZ nr. 48 të datës 16.05.2026 dhe ka marrë votat e nevojshme për tu aprovuar dhe si rezultat dhjetë (10) kandidatët e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak janë certifikuar për të marrë pjesë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 7 Qershor 2026. Pala ka pranuar vendimin e certifikimit të kandidatëve dhe është udhëzuar që palët me interes kanë të drejtë ankesë brenda njëzetë e katër (24) orëve. Në rastin e certifikimit të kandidatëve të subjektit politik Za Slobodu Pfavdu i Opstanak, subjekti politik Srpska Lista nuk është palë interesi, në përputhje me interpretimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të dhënë përmes vendimit AA,nr.60/2024 në rastin e ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje! kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr, 12/2024 i datës 25.12.2024. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konsideron se ankesa e subjektit politik Srpska Lista kundër vendimit të KQZ për certifikimin e kandidatëve të subjektit politik Za Slobodu Pravdu i opstanak për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 7 Qershorit 2026, është e palejuar dhe si e tillë duhet të hidhet poshtë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e ankesës provave të bashkangjitura të njëjtës dhe përgjigjes në ankesë së bashku me prova, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lista serbe” është e pabazuar.

Bazuar në nenin 119 paragraf 1 të LZP-së paneli vlerësoi se subjekti politik “Lista Serbe” ka legjitimitet procedural për të parashtruar ankesë, andaj ky subjekt ka pretenduar se vendimi i KQZ për certifikimin e kandidatëve të subjektit politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” ka cënuar të drejtat dhe interesat e tij në kuadër të procesit zgjedhor

Mirëpo Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar dhe pretendimeve ankimore të cekura në ankesë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 01/824-2026, të datës 16.05.2026, lidhur me certifikimin e kandidatëve të subjektit politik “Za Slobodu, Pravudu i Opstanak”, vlerësoi se ankesa është e pabazuar.

Paneli vëren se pretendimi ankimor i subjektit ankues ishte se kandidatët Alil Đerlek dhe Lazar Radulović nuk i përkasin komunitetit serb dhe rrjedhimisht, nuk mund të kandidojnë për vendet që janë të garantuara për komunitetin serb. Megjithatë, përkundër këtyre pretendimeve, ankuesi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme konkrete dhe bindëse me të cilat do të dëshmohej se kandidatët në fjalë nuk janë pjesë e komunitetit serb apo se ata nuk kanë të drejtë të kandidojnë në kuadër të subjektit politik të certifikuar. Përderisa bazuar në të dhënat nga Regjistri Civil në Republikën e Kosovë nuk paraqitet asnjë dëshmi në lidhje me përkatësinë etnike të individëve dhe rrjedhimisht verifikimi i përkatësisë etnike të kandidatëve nuk mund të bëhet në bazë të interpretimeve subjektive.

Paneli konsideron se barra e të provuarit lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë bie mbi palën ankuese. Andaj vetëm konstatimet e përgjithësuara, në formë supozimi lidhur me përkatësinë etnike të kandidatëve nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e dispozitave kushtetuese apo ligjore dhe as për të kufizuar të drejtën për kandidim në procesin zgjedhor. Kjo për faktin se kandidatët e apostrofuara të cilët janë të përfshirë në listën e subjektit politik “Za Slobodu, Pravudu i Opstanak” merret se janë të deklaruar si pjesëtarë të atij komuniteti dhe përderisa nuk kemi asnjë vendim apo dokument që e kundërshton etninë e këtyre kandidatëve, pretendimet ankimore të subjektit politik “Lista Serbe” mbeten të pabazuara dhe si të tilla nuk kanë mbështetje ligjore.

Ndërsa sa i përket pretendimit të palës ankuese që ndërlidhet me raste të mëhershme ku kandidatë të kombësisë shqiptare kishin qenë të përfshirë në listën e një subjektit politik boshnjak dhe për të cilën KQZ kishte refuzuar certifikimin e atij kandidati, Paneli vlerësoi se secili rast duhet të shqyrtohet si i veçantë dhe mbi bazën e provave konkrete të rastit konkret.

Në këtë rast pala ankuese nuk ka ofruar prova relevante të mjaftueshme dhe bindëse që mund të vërtetonin se KQZ ka vepruar në kundërshtim me ligjin gjatë nxjerrjes së vendimit nr. 01/824-2026. Për rrjedhojë krahasimi me rastet e mëhershme nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tyre ankimore.

Mbi këtë bazë, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë provë konkrete dhe relevante apo dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 3, “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 2, dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, të Rregullores, së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.5/2026 më datën 18.05.2026

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.21/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Qerim Ademaj, anëtarë, lidhur me ankesën e subjektit politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për Certifikimin e kandidateve të subjektit politik “Za Slobodu Pravdu i Opstanak”, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 07 Qershor 2026, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.5/2026, të datës 18.05.2026, në seancën e mbajtur më datë 22.05.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.5/2026, i datës 18.05.2026, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.5/2026, të datës 18.05.2026, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik “Lista Serbe”, me seli në Mitrovica e Veriut, ZP.Anr.5/2026, e datës 17.05.2026, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 01/824-2026, të datës 16.05.2026, për certifikimin e dhjetë (10) kandidateve të subjektit politik “Za Slobodu Pravdu i Opstanak”, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 07 Qershor 2026.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lista Serbe, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljes së rëndë të Kushtetutës së Kosovës, shkeljes së rëndë të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e subjektit politik Lista Serbe,



të anulohet vendimi i PZAP-së, ZP.Anr.5/2026, i datës 18.05.2026, dhe vendimi i KQZ-së Nr. 01/824-2026, i datës 16.05.2026, ashtu që të detyroj KQZ-në të marr një vendim të ri.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lista Serbe, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.5/2026, i datës 18.05.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 16.05.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lista Serbe, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, ku ndër kandidatët e certifikuar janë edhe kandidatët e subjektit politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", përfshirë kandidatë që nuk janë anëtarë të komunitetit serb: Alil Derlek, i cili është shtetas i kombësisë Boshnjake, dhe Lazar Radulović, i cili deklarohet publikisht si Malazez, duke kërkuar më saktësisht si ankesën e parashtruar në PZAP.

KQZ më datë 18.05.2026, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka dhënë sqarime lidhur me procedurën e ndjekur, arsyet dhe rrjedhën se si ka ardhur deri te vendimi i KQZ-së, duke theksuar më saktësisht si në përgjigje në ankesë.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.5/2026, të datës 18.05.2026, me të cilën e ka refuzuar ankesën e subjektit politik, Lista Serbe, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli vëren se pretendimi ankimor i subjektit ankues ishte se kandidatët Alil Derlek dhe Lazar Radulović nuk i përkasin komunitetit serb dhe rrjedhimisht, nuk mund të kandidojnë për vendet që janë të garantuara për komunitetin serb. Megjithatë, përkundër këtyre pretendimeve, ankuesi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme konkrete dhe bindëse me të cilat do të dëshmohej se kandidatët në fjalë nuk janë pjesë e komunitetit serb apo se ata nuk kanë të drejtë të kandidojnë në kuadër të subjektit politik të certifikuar. Përderisa bazuar në të dhënat nga Regjistri Civil në Republikën e Kosovës nuk paraqitet asnjë dëshmi në lidhje me përkatësinë etnike të individëve dhe rrjedhimisht verifikimi i përkatësisë etnike të kandidatëve nuk mund të bëhet në bazë të interpretimeve subjektive.

Ka shtuar se, barra e të provuarit lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë bie mbi palën ankuese. Andaj vetëm konstatimet e përgjithësuara, në formë supozimi lidhur me përkatësinë etnike të kandidatëve nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e dispozitave kushtetuese apo ligjore dhe as për të kufizuar të drejtën për kandidim në procesin zgjedhor. Kjo për faktin se kandidatët e apostrofuar të cilët janë të përfshirë në listën e subjektit politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", merret se janë të deklaruar si pjesëtarë të atij komuniteti dhe përderisa nuk kemi asnjë



vendim apo dokument që e kundërshton etninë e këtyre kandidatëve, pretendimet ankimore të subjektit politik "Lista Serbe" mbeten të pabazuara dhe si të tilla nuk kanë mbështetje ligjore.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese që ndërlidhet me raste të mëhershme ku kandidatë të kombësisë shqiptare kishin qenë të përfshirë në listën e një subjektit politik boshnjak dhe për të cilën KQZ kishte refuzuar certifikimin e atij kandidati, Paneli vlerësoi se secili rast duhet të shqyrtohet si i veçantë dhe mbi bazën e provave konkrete të rastit konkret.

Në këtë rast pala ankuese nuk ka ofruar prova relevante të mjaftueshme dhe bindëse që mund të vërtetonin se KQZ ka vepruar në kundërshtim me ligjin gjatë nxjerrjes së vendimit nr. 01/824-2026. Për rrjedhojë krahasimi me rastet e mëhershme nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tyre ankimore.

Mbi këtë bazë, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë provë konkrete dhe relevante apo dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 3, "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, lidhur me certifikimin e dhjetë (10) kandidateve të subjektit politik "Za Slobodu Pravdu i Opstanak", për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 17 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: "1. Zyra shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji, atëherë Zyra brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm. 2. Aplikuesi i cili pranon njoftimin sipas paragrafit 5 të nenit 13 të këtij ligji, ka afat pesë (5) ditë pune për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuara në njoftim. 3. Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje. 4. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve. 5. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe në rast të refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për t'u ankuar



në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve. PZAP vendos për ankesën brenda dyze e tetë (48) orëve nga pranimi i saj.”.

Me nenin 11 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të këtij ligji, parashihet se: “1. Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës. 2. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend zgjidhen me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura dhe ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: 2.2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.”.

Me nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë ikufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Me nenin 57 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute. 2. Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim. 3. Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet. 4. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me



vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve”.

Me nenin 58 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare. 2. Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave. 3. Republika e Kosovës do të ndërmerri të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t’u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar. 4. Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit. 5. Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet. 6. Republika e Kosovës ndërmerri veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikrat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t’i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë. 7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuar me këtë Kushtetutë”.

Me nenin 64 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: “1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. 2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon: (2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.



Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozitat e lartcekura, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik Lista Serbe është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimi i ankuesit se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia kanë shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 3, 24, 45, 57, 58, 64 dhe 81, nuk qëndron dhe mbetet i pabazuar, për faktin se ankuesi nuk ka arritur të ofrojë prova konkrete, të besueshme dhe bindëse për të mbështetur pretendimin e tij se kandidatët për deputetë të certifikuar nga KQZ-ja nuk i përkasin komunitetit serb, por komunitetit malazez përkatësisht ati boshnjak. Në mungesë të provave të tilla, nuk mund të konstatohet se institucionet zgjedhore kanë vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese të barazisë para ligjit, të drejtave zgjedhore apo mbrojtjes së komuniteteve, të garantuara me nenet e lartcekura të Kushtetutës.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, provat e bashkëngjitura nga ankuesi, të cilat konsistojnë kryesisht në publikime apo artikuj të portaleve elektronike, nuk mund të konsiderohen prova relevante dhe të mjaftueshme në kuptim juridik për të vërtetuar përkatësinë etnike të kandidatëve të certifikuar. Artikujt medialë apo publikimet në portale nuk përbëjnë dokumentacion zyrtar dhe nuk kanë fuqi provuese për të rrëzuar vendimet e organeve kompetente zgjedhore, sidomos në mungesë të ndonjë dokumenti publik, deklarimi zyrtar apo evidence tjetër objektive që do të dëshmonte pretendimet e ngritura nga ankuesi. Për rrjedhojë, vetëm supozimet apo interpretimet subjektive të bazuara në raportime mediale nuk mund të shërbejnë si bazë për të konstatuar shkelje kushtetuese nga KQZ-ja apo PZAP-ja.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se barra e të provuarit bie mbi ankuesin, i cili ka për obligim të paraqesë prova të qarta dhe bindëse për pretendimet e tij. Duke qenë se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova relevante se kandidatët e certifikuar nuk i përkasin komunitetit serb, atëherë pretendimet për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës lidhur me barazinë para ligjit, nenit 45 lidhur me të drejtat zgjedhore, si dhe neneve 57, 58, 64 dhe 81 që ndërlidhen me mbrojtjen dhe përfaqësimin e komuniteteve, mbesin në nivel deklarativ dhe si të tilla nuk mund të pranohen si të bazuara

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kësaj ankese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas ankesës të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.21/2026 datë 22.05.2026.

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Dylásčeni radnik